



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
KRYETARI

Adresa: Kontrolli i Lartë i Shtetit, Rruga "Abdi Toptani" Nr.1 Tiranë. E-mail: klsh.org.al; web-site: www.klsh.org.al

Nr.246/7Prot.

Tiranë, më 30.06.2018

V E N D I M

Nr.73 , Datë 30.06.2018

PËR

**AUDITIMIN E USHTRUAR NË BASHKINË MALLAKASTËR MBI AUDITIMIN E
PËRPUTHSHMËRISË
për periudhën nga data 01.01.2016 deri më datën 31.12.2017.**

Nga auditimi i ushtruar në Bashkinë Mallakastër, rezultoi që veprimtaria ekonomike e financiare përputhet në përgjithësi me kërkesat dhe kriteret e kuadrit rregullator në fuqi në drejtim të planifikimit, miratimit, monitorimit dhe zbatimit të buxhetit. Për periudhën objekt i auditimit u konstatuan dhe të meta e dobësi me pasoja financiare në drejtim të procedurave të prokurimit dhe zbatimit të kontratave për punë publike.

Pasiu njoha me Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe Projektvendimin e paraqitur nga Grupi i Auditimit të Departamentit të Auditimit të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore, shpjegimet e dhëna nga subjekti i audituar, si dhe vlerësimet mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit të mësipërm, Drejtori i Departamentit Juridik dhe Kontrollit të Zbatimit të Standardeve të Auditimit dhe Etikës si dhe Drejtori i Përgjithshëm, në mbështetje të neneve 10, 15, 25 dhe 30, të ligjit nr.154/2014 miratuar në datën 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit",

VENDOSA

I. Të miratoj Raportin Përfundimtar të Auditimit të Përputhshmërisë të ushtruar në Bashkinë Mallakastër, sipas programit të auditimit nr. 246/2, datë 05.03.2018 ndryshuar me nr. 246/3, datë 16.04.2018 për veprimtarinë nga data 01.01.2016 deri në 31.12.2017.

II. Të miratoj rekomandimet për përmirësimin e gjendjes dhe të kërkoj marrjen e masave sa vijon;

A. MASA ORGANIZATIVE

1.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të prokurimit publik për periudhën objekt auditimi u konstatua se dosjet e procedurave të prokurimit nuk janë inventarizuar dhe arkivuar

me numër fletësh në kundërshtim me udhëzimet e APP-së, nenin 30 të Modelit nr. 8 “Norma Tekniko Profesionale dhe Metodologjike të Shërbimit Arkivor në Republikën e Shqipërisë” miratuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave në zbatim të nenit 3 e 29 të ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për Arkivat” (Trajtuar në faqet 33-77 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1.Rekomandimi:Bashkia Mallakastër, të marrë masa për sistemin e dosjeve të procedurave të prokurimit, inventarizimin dhe arkivimin e tyre, sipas lidhjeve dhe në mënyrë kronologjike.

Menjëherë

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dy procedurave të prokurimit publik me objekt “Rehabilitimi i rrjetit ujëtës në zonën e Kutës (Rezervuari Çorrush nr.1), (vazhdim)”, me fond limit 20,833,333 lekë, zhvilluar në datë 04.05.2017, kontrata lidhur më datë 05.06.2017 dhe “Rikonstruksion dhe shtesë kati në ndërtesën e Bashkisë”, me fond limit 49,999,932 lekë, zhvilluar në datë 10.05.2017, kontrata lidhur më datë 05.06.2017, u konstatua se në të dyja këto procedura është shpallur fitues dhe lidhur kontratë me të njëjtin operator ekonomik (“Sh...” shpk). Nga auditimi rezultoi se shoqëria “Sh...” shpk ka deklaruar të njëjtat makineri dhe pajisje në të dy procedurat dhe si rrjedhojë nuk ka kapacitet të nevojshëm për të realizuar të dyja kontratat njëkohësisht duke parë që të dyja kontratat pothuajse janë me të njëjtin afat realizimi (3 dhe 4 muaj). **Fakt i cili flet për paraqitje dokumentacioni të rremë nga ana e OE “Sh...” shpk** në lidhje me disponimin dhe mospërdorimin e makinerive në objekt tjetër, si pasojë, KVO duhej ta kishte dërguar për përjashtim nga prokurimet publike në APP. Veprime këto në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, Neni 13, pika 3/a, dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për rregullat e prokurimit publik”, neni 66, “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave” (Trajtuar në faqet 33-77 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2.1 Rekomandim:Bashkia Mallakastër në cilësinë e Autoritetit Kontraktor të marrë masa për vlerësim të drejtë të dhënies dhe përfitimit të kontratave në përmbushje të detyrimeve ligjore të nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, Neni 13, pika 3/a, dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për rregullat e prokurimit publik”, neni 66, “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave”.

Në vijimësi

3. Gjetje nga auditimi: Nga Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit Vendor Bashkia Mallakastër, nuk është vepruar për të arkëtuar vlerën e gjobave të vendosura për shkeljet e konstatuara në ndërtimet pa leje ndërtimi, për arkëtimin e tyre, nuk është ndjekur rruga ligjore me padi në gjykatë, në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 10279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative” nenet 20, 30 dhe të Ligjit nr.9780, datë 16.07.2007 “Për Inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, i ndryshuar, **me efekt financiar negativ, të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë, në vlerën 50,000 lekë, për 1 rast** (Trajtuar në faqet 110-114 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

3.1. Rekomandimi: Bashkia Mallakastër, Zyra e IVMT, të marrë masa dhe të ndiqen të gjitha rrugët ligjore deri në padi në gjykatë, për arkëtimin e gjobave të pa arkëtuara në vlerën 50,000 lekë, për 1 subjekt, për shkeljet e konstatuara në kryerjen e punimeve pa leje ndërtimi.

Menjëherë

4. Gjetje nga auditimi: Nuk janë zbatuar rekomandimet e KLSH, dërguar me shkresën nr. 1113/128, datë 31.01.2017, protokolluar në subjekt me shkresën nr. 226, datë 06.02.2017 ku,nga

17 masa organizative të rekomanduara, janë pa zbatuar plotësisht 7 masa; nga 14 masa për shpërbllim dëmi është bërë kontabilizimi për vlerën 48,730,994 lekë, për të cilat janë nxjerrë urdhër njoftimet. Nga 14 masa shpërbllim dëmi në total, 8 masa për vlerën 1,912,345 lekë janë në proces zbatimi pasi janë arkëtuar pjesërisht, 6 masa janë në proces gjyqësor për vlerën 46,069,502, 1 masë në vlerën 35,400 është zbatuar plotësisht, 1 masë në vlerën 17,747 lekë është e pa zbatuar. Masat Disiplinore janë zbatuar plotësisht. Masat administrative për 5 persona janë në proces (*Trajtuar në faqet 116-141 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

4.1 Rekomandimi: Nga Kryetari i Bashkisë dhe Zyra Juridike, të marren të gjitha masat duke ndjekur të gjitha shkallët gjyqësore për arkëtimin e dëmit të shkaktuar buxhetit të shtetit të konstatuar nga auditimi i mëparshëm i KLSH, në vlerën **46,695,594 lekë**.

Menjëherë

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dosjes teknike të objektit “*Rikonstruksion i pjesshëm i rrugëve në fshatrat e Bashkisë Mallakastër*”, rezulton se ky objekt përbëhet nga katër nën objekte. Në projektin e zbatimit të administruar në dosje, në formatin A4, i cili është pa firmën e titullarit të AK, konstatohet se:

- Nën objekti “Rruga, nga rruga nacionale Ninësh - Damës” ka planimetritë, profilin gjatësor dhe dy prerje tërthore tip. Mungon azhurnimi topografik i objektit (profilet tërthore).

- Nën objekti “Rruga nga rruga nacionale Mollaj” ka planimetrinë, profilin gjatësor, një prerje tërthore tip dhe pesë nga 12 profile tërthore. Mungon azhurnimi topografik i pjesës tjetër të objektit.

- Nën objekti “Rruga nga rruga nacionale Romës” ka planimetrinë dhe një prerje tërthore tip. Mungon profili gjatësor dhe azhurnimi topografik i objektit (profilet tërthore).

- Nën objekti “Rruga nga rruga nacionale deri në Çorrush” ka vetëm një planimetri në formatin A4 (*Trajtuar më hollësisht në faqet 77-109 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

5.1. Rekomandimi: Nga Bashkia Mallakastër të merren masa që, para hedhjes së objekteve në sistemin elektronik të prokurimeve, të bëhet plotësimi i projektit të zbatimit, në mënyrë që objektet të realizohen sipas projektit dhe ndryshimet të bëhen me amendamentet përkatëse, duke shmangur kryerjen e punimeve jashtë projektit.

Menjëherë dhe në vijimësi

6. Gjetje nga auditimi: Në dosjen teknike të objektit “*Rikonstruksion i pjesshëm i rrugëve në fshatrat e Bashkisë Mallakastër*”, nuk administrohet detyrë projektimi, por vetëm një relacion teknik, ku përcaktohen llojet e ndërhyrjeve. Nga verifikimi në terren i objektit dhe auditimi i dokumentacionit teknik, rezulton se projekti i këtij objekti është i një cilësie të dobët dhe jo i plotë. Konstatohet se cilësia e punës është e keqe dhe objekti ka filluar të amortizohet. Objekti është në periudhën e garancisë së defekteve dhe sipërmarrësi është i detyruar që të bëjë riparimet e duhura me shpenzimet e veta, në zbatim të pikës 1.6 të specifikimeve teknike (*Trajtuar më hollësisht në faqet 77-109 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

6.1. Rekomandimi: Nga Bashkia Mallakastër të merren masa për ndjekjen dhe monitorimin e zbatimit të objekteve ndërtimore sipas kontratës dhe të detyrojë sipërmarrësin e objektit të audituar për riparimin e defekteve me shpenzimet e tij, brenda periudhës së garancisë së defekteve.

Menjëherë

7. Gjetje nga auditimi: Bashkia Mallakastër nuk ka funksionuar në bazë strategjish periodike dhe objektiva prioritar. Nga auditimi dhe komunikimi me subjektin rezulton se për periudhën objekt i auditimit në Bashkinë Mallakastër nuk janë parashikuar plane vjetore dhe operacionale aktivitetesh për realizimin e objektivave por ndjekja e realizimit të detyrave dhe përgjegjësi të

përshkruara në rregulloren e brendshme si dhe monitorimi e raportimi funksionojnë në mënyrë operative si dhe nuk ka aplikuar metodën e vlerësimit dhe menaxhimit të risqeve që kërcënojnë realizimin e objektivave dhe respektivisht realizimin e funksioneve kryesore të ngarkuara sipas kuadrit rregullator në fuqi. Nga auditimi i evidencës së grumbulluar, raportimet e nivelit drejtues dhe përgjigjet e stafit të administratës në pyetësorët e aplikuar për këtë qëllim rezultojnë se nuk janë organizuar trajnime për rritjen e kapaciteteve profesionale dhe veçanërisht në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm. *(Sa më sipër trajtuar në detaje në faqet nr. 17-25 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

7.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Mallakastër, në ushtrim të përgjegjshmërisë menaxheriale të institucionit që drejton, të formojë një grup pune me specialistë me njohuri të spikatura profesionale me qëllim që:

a) Të organizojë punën për vlerësimin e situatës aktuale të veprimtarisë së bashkisë identifikimin e dobësive, kërcënimeve dhe oportuniteteve dhe ndërtimin e strategjisë afatmesme e afatshkurtër të bashkisë duke marrë në konsideratë prioritetet e Bashkisë në vijimësi.

b) Pas përfshirjes në strategji të rritjes dhe forcimit të kapaciteteve profesionale si objektivi prioritar, të vlerësojë nevojat për trajnime të stafit kryesisht në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm dhe të hartojë plane vjetore dhe operacionale aktivitete për realizimin e objektivave në tërësi dhe ato në fushën e trajnimeve në veçanti.

7.2 Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë nëpërmjet koordinatorit të riskut të ndërtojë një plan pune me detyra të mirë përcaktuara për të organizuar punën në bashki për aplikimin e funksionimit të institucionit me bazë vlerësimin dhe menaxhimin e riskut në çdo nivel të administratës dhe dokumentimin në regjistrin qendror të riskut në vazhdimësi si rezultat i rishikimit dhe rivlerësimit të risqeve me qëllim garantimin e arsyeshmëri dhe në nivel sa më optimal të realizimit të objektivave dhe misionit të bashkisë.

Rekomandimet sa më sipër, në referencë të përcaktimeve në ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar me ligjin nr. 110/2015, neni 8, pika 8; neni 10; neni 16; neni 21; dhe Manuali për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 8980, datë 15.07.2010.

Deri më 31.12.2018

8. Gjetje nga auditimi: Për vitin 2016, Drejtoria Ekonomike ka analizuar situatën dhe ka parashikuar nevojat për buxhetin e vitit 2016 në bazë drejtorish por që nuk është dokumentuar. Duke qenë se buxheti i miratuar nuk ka qenë në përputhje me nevojat reale të bashkisë për vitin 2016, mbështetur dhe në shtimin e funksioneve gjatë vitit, janë realizuar shtesa fondesh gjatë vitit dhe rialokime të cilat janë miratuar në Këshillin Bashkiak. Për vitin 2017, bashkia është përfshirë në procesin e përgatitjes së PBA 2017-2019 dhe buxhetin korent për vitin 2017. Formalisht PBA e parashikuar dhe propozuar i qëndron programeve të institucionit dhe argumentet parashikohen në praktikën e përgatitjes së PBA. Në rubrikat e pasqyrave mbi parashikimet buxhetore evidentohet se në mënyrë skematike është respektuar programi buxhetor por nuk janë përshkallëzuar në nivel bashkie në kuptimin e parashikimit dhe llogaritjes së nevojave sipas objektivave të programit me aktivitete të cilat bëjnë të mundur realizimin e objektivave të programit. Në procesin e buxhetimit, miratimit, zbatimit e monitorimit nuk është siguruar gjithë përfshirje e administratës si dhe nuk kanë funksionuar grupet për menaxhimin strategjik dhe ato individuale në bazë sektorësh *(Sa më sipër trajtuar në detaje në faqet nr. 25-33 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

8.1 Rekomandimi: Drejtoria Ekonomike në bashkëpunim me Sektorin e Burimeve Njerëzore dhe atë të shërbimeve të marrin masa për të organizuar procesin e përgatitjes së projektbuxhetit afatmesëm dhe atë të vitit korrent sipas përcaktimeve në Ligjin nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe udhëzimet vjetore të

Ministrisë Financave për përgatitjen e projektbuxhetit duke identifikuar nevojat reale për fonde dhe burimet e disponueshme me qëllim shmangien e alokimeve gjatë vitit dhe rialokime të cilat vështirësojnë realizimin e objektivave prioritar të programeve buxhetore. Fondet sipas programeve të lidhen me politikat dhe objektivat e programit dhe të shtrihen në nivel aktiviteti për të argumentuar domosdoshmërinë e fondeve të kërkuara duke përmirësuar punën e nisur në projektbuxhetin e vitit 2018 dhe përafruar me standardet dhe procedurat e përgatitjes së projektbuxhetit sipas përcaktimeve në aktet normative relevante në fuqi, kryesisht Ligjin nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe udhëzimet periodike të MF për përgatitjen e PBA dhe projektbuxhetit të vitit korrent.

Brenda vitit 2018

9.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i pasqyrave financiare rezulton se është bërë praktikë mbyllja e llogarive vjetore, çelja e tyre, përpilimi i pasqyrave financiare dhe bilancit kontabël mbështetur vetëm në situacionet buxhetore të shpenzimeve dhe të ardhurave të rakorduara me thesarin dhe që i bashkëngjiten pasqyrave financiare dhe jo mbështetur në sistemin ditar-libër i madh apo ditar analitik-centralizator sipas përcaktimeve në VKM nr. 248, datë 10.4.1998 dhe Planit Kontabël të Përgjithshëm miratuar me VKM nr. 334, datë 09.07.1993.

Në pasqyrat financiare nuk është praktikuar pasqyra e konsoliduar e gjendjes financiare Aktiv-Pasiv dhe pasqyra e konsoliduar e të ardhurave dhe shpenzimeve të funksionimit, respektivisht formati 10 dhe 11 i miratuar i pasqyrave financiare. Shënimet shpjeguese për hartimin e llogarive janë të vakta dhe jo në të gjitha rubrikat e kërkuara në formatin 12 të pasqyrave financiare. *(Sa më sipër trajtuar në detaje në faqet nr. 20-22 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

9.1 Rekomandimi: Drejtoria Ekonomike (Sektori i Financës) të analizojë situatën dhe procedurat e regjistrimit të ngjarjeve ekonomike duke patur në konsideratë burimet e disponueshme njerëzore, të evidentojë dobësitë në procesin e mbajtjes dhe mbartjes së të dhënave financiare, të ndajë punën në bazë të kapaciteteve profesionale të sektorit dhe mbi bazën e konkluzioneve të hartojë një program pune për instalimin, në mbajtjen e kontabilitetit, të sistemit ditar-libër i madh ose ditar analitik-centralizator me qëllim sigurimin e regjistrimit në kohë reale të ngjarjeve ekonomike, mbartjen periodike dhe raportimin financiar në kohën e kërkuar si dhe forcimin e kontrollit financiar në procesin e kuadrimin dhe mbylljes së llogarive vjetore dhe bilancit kontabël sipas kërkesave të VKM nr. 248, datë 10.4.1998 dhe Planit Kontabël të Përgjithshëm miratuar me VKM nr. 334, datë 09.07.1993 dhe veçanërisht në përputhje me Udhëzimin e MF nr. 14, datë 28.12.2006 “Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare”.

Brenda vitit 2018

10.Gjetje nga auditimi: Pranë sektorit të financës është caktuar një specialiste për asetet. Nga verifikimi rezulton se nuk është krijuar një database për pronat që me VKM respektive i kanë kaluar Bashkisë Mallakastër. Administrohen vetëm listat e pronave sipas VKM për ish-bashkinë dhe ish-komunat që janë shkrirë në Bashkinë Mallakastër pas reformës territoriale administrative. Ende nuk ka filluar regjistrimi i pronave në ZVRPP me argumentin se nevojiten fonde për regjistrim dhe kjo është në pamundësi të bashkisë për fondet në dispozicion për të mbuluar regjistrimin e tyre në ZVRPP si dhe për mosplotësim të kërkesave të bashkisë nga ZVRPP mbi statusin juridik të pronave që kanë kaluar bashkisë me VKM përkatëse. Rezulton gjithashtu se nuk është ndërmarrë nisma për vlerësimin e pronave dhe regjistrimin si angazhim në librat e llogarisë së institucionit. *(Sa më sipër trajtuar në detaje në faqet nr. 109-115 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

10.1 Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Mallakastër të marrë masa për krijimin e një sektori për menaxhimin dhe administrimin e pronave të bashkisë që me VKM kanë kaluar në pronësi apo

përdorim me përbërje specialistë të fushës juridike dhe topografike me qëllim që të hartohen praktikatat e aplikimit në ZVRPP për regjistrimin e pronave dhe ndjekjen e punës në bashkëpunim me Drejtorinë Ekonomike për verifikimin dhe rivlerësimin kontabël të tyre duke siguruar kontrollin juridik dhe efektiv mbi pronat e bashkisë duke bërë të mundur mobilizimin e tyre për krijimin e të ardhurave nga dhënia me qira e pronave.

Menjëherë

B.I MASA SHPËRBLIM DËMI

Bazuar në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” neni 15 germa (b) dhe (c) –*Të drejtat e KLSH* dhe mbështetur në nenet 98-102, të ligjit nr. 44/2015, datë 30.04.2015 “Kodi i procedurave administrative në Republikën e Shqipërisë”, nenet 21-33, të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” dhe pikën 93, të udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, nga Titullari i njësisë publike, të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore (Padi Gjyqësore) duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit në total në vlerën **15,313,645 lekë** nga të cilat: **6,892,925 lekë** në zbatimin e kontratave për punë publike; **8,085,962 lekë** pa mundësi arkëtimi, në procedurat e prokurimit dhe, **334,758 lekë** në shpenzimet operative sipas urdhërshpenzimeve të bankës. Nëpunësi zbatues të ndjekë procesin dhe të kryej regjistrimet e nevojshme kontabël përfundimtare, me qëllim shpërblimit të dëmit në vlerën 7,227,683 lekë, si më poshtë:

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit të kontratës me objekt “Rehabilitim i pjesshëm i rrjetit ujitës të rezervuarit Çorrushi Nr. 1, Kutë, Mallakastër” të lidhur ndërmjet Autoritetit Kontraktor Bashkisë Mallakastër dhe shoqërisë “Sh...” SHPK, u konstatua se, në zërat e punimeve: “3.59/b Gërmim themeli i veçuar, gropa me sip. 10-30 m², në tokë të zakonshme, me h=1.5 m”, “4.7 F.V Tuba përfshi pjesët speciale me saldim me llamarinë të zezë të kalandruar të vendosur në estakada Ø 600 mm” dhe zërit “3.25 Gërmim me krahë seksion i detyruar me gjerësi b>1 m, h= 1.5 m” rezultojnë diferenca në volume për punime të pakryera duke shkaktuar një dëm ekonomik për buxhetin e Bashkisë në vlerën 241,132 lekë. (Sa më sipër trajtuar në detaje në faqen nr. 91 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1 Rekomandimi: Të merren masa nga Bashkia Mallakastër, që t’i kërkojë operatorit ekonomik “Sh...” SHPK duke ndjekur të gjitha procedurat e duhura administrative si dhe të gjitha shkallët e gjykimit arkëtimin e shumës **241,132 lekë**, të përfituara më tepër për diferenca në volume për punime të pakryera inxhinierike duke shkaktuar një dëm ekonomik në zbatimin e kontratës “Rehabilitim i pjesshëm i rrjetit ujitës të rezervuarit Çorrushi Nr. 1, Kutë, Mallakastër”.

Menjëherë

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit të kontratës me objekt “Rehabilitim i pjesshëm i rrjetit ujitës të rezervuarit Çorrushi Nr. 1, Kutë, Mallakastër” (vazhdim) të lidhur ndërmjet Autoritetit Kontraktor **Bashkisë Mallakastër** dhe BOE “Sh...” SHPK Fier & “F...” SHPK, u konstatua se në zërat e punimeve: “3.25/b, Gërmim dheu me krahë” dhe “3.288, Hekur betoni (Në formë zgare 20 x 20 cm, Ø 8 mm) për përforsim” rezultojnë diferenca në volume për punime të pakryera duke shkaktuar një dëm ekonomik për buxhetin e Bashkisë në vlerën **1,145,333 lekë me TVSH**. (Sa më sipër trajtuar në detaje në faqen nr. 96 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2.1 Rekomandimi: Të merren masa nga Bashkia Mallakastër, që t’i kërkojë BOE “Sh...” SHPK & “F...” SHPK duke ndjekur të gjitha procedurat e duhura administrative si dhe të gjitha shkallët e gjykimit arkëtimin e shumës **1,145,333 lekë me TVSH**, të përfituara më tepër për

diferenca në volume për punime të pakryera duke shkaktuar një dëm ekonomik në zbatimin e kontratës “Rehabilitim i pjesshëm i rrjetit ujitës të rezervuarit Çorrushi Nr. 1, Kutë, Mallakastër” (vazhdim).

Menjëherë

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt “Rikonstruksion i pjesshëm i rrugëve në fshatrat e Bashkisë Mallakastër”, me vlerë të kontratës (me tvsh) 63,930,000 lekë, fituar nga Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë “F..” Sh.p.k & “Sh...” Sh.p.k, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën **5,506,460 lekë pa tvsh**. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 2326 prot datë 29.12.2016 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Mallakastër dhe “F...” Sh.p.k & “Sh...” Sh.p.k (Trajtuar më hollësisht në faqen 77 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

3.1. Rekomandimi: Nga Bashkia Mallakastër të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **5,506,460 lekë pa tvsh** nga Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë “F...” Sh.p.k & “Sh...” Sh.p.k, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën nr. 2326 prot datë 29.12.2016 me objekt “Rikonstruksion i pjesshëm i rrugëve në fshatrat e Bashkisë Mallakastër”, vlerë kjo e cila përfaqëson një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si rrjedhojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

Menjëherë

4. Gjetje nga auditimi: Në procedurën e prokurimit me objekt “Rehabilitimi i rrjetit ujitës në zonën e Kutës (Rezervuari Çorrush nr.1), (vazhdim)”, me fond limit 20,833,333 lekë, zhvilluar në vitin 2017, fitues OE “Sh...” shpk me vlerë të ofertës 20,490,700 lekë, u konstatua se: KVO ka vepruar **me 2 standarde** pasi ka s’kualifikuar nga gara operatorin ekonomik *me vlerë më të ulët* “B...” shpk, me vlerë të ofertës 18,782,600 lekë, për mangësi në plotësimin e kriterëve të veçanta të kualifikimit, të cilat nga auditimi u konstatua se nuk i ka plotësuar edhe OE kualifikuar dhe shpallur fitues “Sh...” shpk, *me vlerë më të lartë*, dhe nuk është konstatuar nga KVO, çka i ka shkaktuar buxhetit të shtetit impakt financiar negativ me **dëm ekonomik në vlerën 1,708,100 lekë** pa mundësi arkëtimi, të llogaritur si diferencë nga oferta e OE “Shendelli” shpk minus (-) ofertën e OE “B B” shpk (20,490,700 - 18,782,600) = 1,708,100 lekë. Veprime këto në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, Neni 1.

“Objekti dhe qëllimi” pika 2, germa (a), (b), (d) dhe (dh), Neni 2 “Parimet e përzgjedhjes” germa (a), (b) dhe (c), Nenin 20 “Mos diskriminimi” dhe me Nenin 46, 53 dhe 55 (Trajtuar në faqet 33-38 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

4.1. Rekomandim: Kryetari i Bashkisë, nëpërmjet strukturave përgjegjëse, të marrë masa për analizimin dhe nxjerrjen e përgjegjësisë për zhdëmtimin e vlerës **1,708,100 lekë**, ndaj personave përgjegjës për procedurën e prokurimit, duke u udhëhequr nga qëllimi kryesor i ligjit për prokurimet publike ai i sigurimit të dobishmërisë maksimale të fondeve të prokuruar, të cilat nuk çenojnë thelbin e zbatimit të kontratës, procedura të cilat deri më tani kanë sjellë pasoja me efekte negative.

Brenda vitit 2018

5. Gjetje nga auditimi: Në procedurën e prokurimit me objekt “Rikonstruksion dhe shitesë kati në ndërtesën e Bashkisë”, me fond limit 49,999,932 lekë, zhvilluar në vitin 2017, fitues OE “Sh...” shpk me vlerë të ofertës 48,273,192 lekë, u konstatua se: KVO ka vepruar **me 2 standarde** pasi ka s’kualifikuar nga gara operatorin ekonomik *me vlerë më të ulët* “B...” shpk, me vlerë të ofertës 46,244,287 lekë, për mangësi në plotësimin e kriterëve të veçanta të kualifikimit, të cilat nga auditimi u konstatua se nuk i ka plotësuar edhe OE kualifikuar dhe shpallur fitues “Sh...” shpk, *me vlerë më të lartë*, dhe nuk është konstatuar nga KVO, çka i ka shkaktuar buxhetit të shtetit impakt financiar negativ me **dëm ekonomik në vlerën 2,028,905**

lekë pa mundësi arkëtimi, të llogaritur si diferencë nga oferta e OE “Sh...” shpk minus (-) ofertën e OE “B...” shpk (48,273,192 - 46,244,287) = 2,028,905 lekë. Veprime në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, Neni 1 “Objekti dhe qëllimi” pika 2, germa (a), (b), (d) dhe (dh), Neni 2 “Parimet e përzgjedhjes” germa (a), (b) dhe (c), Nenin 20 “Mos diskriminimi” dhe me Nenet 46, 53 dhe 55 (*Trajtuar në faqet 39-45 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

5.1. Rekomandim: Kryetari i Bashkisë, nëpërmjet strukturave përgjegjëse, të marrë masa për analizimin dhe nxjerrjen e përgjegjësishë për zhdëmtimin e vlerës **2,028,905 lekë**, ndaj personave përgjegjës për procedurën e prokurimit, duke u udhëhequr nga qëllimi kryesor i ligjit për prokurimet publike ai i sigurimit të dobishmërisë maksimale të fondeve të prokuruar, të cilat nuk çenojnë thelbin e zbatimit të kontratës, procedura të cilat deri më tani kanë sjellë pasoja me efekte negative.

Brenda vitit 2018

6. Në procedurën e prokurimit me objekt “*Rikualifikimi urban i lagjes “28 Nëntori” të qytetit Ballsh*”, me fond limit 77,853,482 lekë, zhvilluar në vitin 2017, Fitues BOE “2..” shpk & “G...” shpk me vlerë të ofertës 77,491,570 lekë, u konstatua se: KVO padrejtësisht ka kualifikuar dhe shpallur fitues BOE “2..” shpk & “G...” shpk, pasi nuk ka plotësuar kërkesat e DST. Si pasojë, tenderi duhej anuluar dhe duhej zhvilluar procedurë e re, çka nuk ka ndodhur, duke shkaktuar **mos përdorim me efektivitet, eficientë dhe ekonomikitet të fondeve në vlerën në shumën 4,348,957 lekë**, të llogaritur si diferencë nga oferta e shpallur fituese të BOE “2..” shpk & “G...” shpk minus (-) ofertën e s’kualifikuar të OE “B...” shpk (77,491,570 - 73,142,613) = 4,348,957 lekë. Veprime në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, Neni 1, “Objekti dhe qëllimi”, pika 2, germa a, b, d dhe dh, dhe Neni 2 “Parimet e përzgjedhjes”, germa a, b dhe c, Neni 24 “Anulimi i një procedure prokurimi” dhe nenin 46 “Kualifikimi i ofertuesve” (*Trajtuar në faqen 48 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

6.1. Rekomandim: Kryetari i Bashkisë, nëpërmjet strukturave përgjegjëse, të marrë masa për analizimin dhe nxjerrjen e përgjegjësishë për zhdëmtimin e vlerës **4,348,957 lekë** ndaj personave përgjegjës për procedurën e prokurimit, duke u udhëhequr nga qëllimi kryesor i ligjit për prokurimet publike ai i sigurimit të dobishmërisë maksimale të fondeve të prokuruar, të cilat nuk çenojnë thelbin e zbatimit të kontratës, procedura të cilat deri më tani kanë sjellë pasoja me efekte negative.

Brenda vitit 2018

7. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i urdhërshpenzimeve me bankë për vitin 2016 u konstatua se në bazë të kontratës nr. 121, datë 25.01.2016 të lidhur midis Bashkisë Mallakastër dhe subjektit fizik A.V., Ballsh me NIPT me objekt “Furnizim dhe vendosje pjesë këmbimi dhe shërbime për automjetet e Bashkisë Mallakastër” në vlerën 2,402,193 lekë pa TVSH, janë kryer furnizimet, vendosja dhe shërbimet sipas përcaktimit në kontratë për automjetet e bashkisë dhe është kryer likuidimi i shpenzimeve jo sipas gjendjes në fakt të vërtetuar nga procesverbalet e marrjes së tyre në dorëzim nga komisioni i ngritur për këtë qëllim por më tepër në shumën **334,758 lekë** e cila përbën dëm ekonomik për buxhetin e bashkisë. Mos justifikimi i realizimit të furnizimit, riparimit dhe shërbimit sa trajtuar në USHP e mësipërme nuk përputhet me kërkesat e Udhëzimit të MF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, pika 10, 35, 37, 42, 43,dhe 54; për zbatimin e ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” të cilat kanë sjellë për pasojë dëm ekonomik për buxhetin e bashkisë në shumën **334,758 lekë**. (*Trajtuar më hollësisht në faqet 101-105 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*)

7.1. Rekomandimi: Nga Bashkia Mallakastër të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **334,758 lekë**nga subjekti fizik A.V., Ballsh me NIPT për përfitim të vlerës për furnizim, vendosje pjesë këmbimi dhe shërbime të pa kryera, të vërtetuara më dokumentacionin përkatës nga komisioni i marrjes së mallrave në dorëzim.

Menjëherë

B.II PËRDORIM JO ME EFIKTIVITET, EFICENCË DHE EKONOMICITET I SHPENZIMEVE NË FUSHËN E PROKURIMEVE PUBLIKE.

Në auditimin e procedurave të prokurimeve, të zhvilluara në Bashkinë Mallakastër, u konstatua se **1 procedurë prokurimi** është kryer në kundërshtim me nenin 2, “Parimet e përzgjedhjes”, nenin 55, “Kriteret e përcaktimit të ofertës fituese”, nenin 24, “Anulimi i një procedure prokurimi” dhe pika 5 e nenit 53, “Shqyrtimi i ofertave”, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar, pasi:

Operatorët ekonomikë janë shpallur fitues edhe pse kanë mangësi në dokumentacionin e paraqitur sipas kërkesave të DST, të miratuara nga Autoriteti Kontraktor (këtu e në vijim AK) dhe Njësia e Hartimit të Dokumenteve të Tenderit (këtu e në vijim NJHDT), duke mos anuluar këto procedura, veprime këto me impakt negativ në buxhet për procedurat e prokurimit të shpallura fituese në **vlerën totale të fondit limit 161,057,883 lekë, duke favorizuar operatorët ekonomikë, në shumën 6,686,327 lekë, mos përdorim me efektivitet, eficencë dhe economicitet i fondeve, të llogaritura si diferencë e vlerave të ofertave ekonomike në kundërshtim me dispozitat e ligjit të prokurimit publik dhe shpallur fitues me kriteret të paplota e konkretisht si më poshtë:**

1. Në procedurën e prokurimit me objekt “*KUZ Lagjja “Bylis”, qyteti Ballsh*”, me fond limit 83,204,401 lekë, zhvilluar në vitin 2017, Fitues OE “B...” shpk me vlerë të ofertës 82,400,968 lekë, u konstatua se: KVO padrejtësisht ka kualifikuar dhe shpallur fitues OE “B...” shpk, me vlerë 82,400,968 lekë, pasi nuk ka plotësuar kërkesat e DST. Si pasojë, tenderi duhej anuluar dhe duhej zhvilluar procedurë e re, çka nuk ka ndodhur, duke shkaktuar **mos përdorim me efektivitet, eficencë dhe economicitet të fondeve në vlerën në shumën 6,686,327 lekë**, të llogaritur si diferencë nga oferta e shpallur fituese të OE “B...” shpk minus (-) ofertën e s’kualifikuar të OE “Bo...” shpk (82,400,968 - 75,714,641) = 6,686,327 lekë. Veprime në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, Neni 1, “Objekti dhe qëllimi”, pika 2, germa a, b, d dhe dh, dhe Neni 2 “Parimet e përzgjedhjes”, germa a, b dhe c, Neni 24 “Anulimi i një procedure prokurimi” dhe nenin 46 “Kualifikimi i ofertuesve” (*Trajtuar në faqen 53 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

1.1.Rekomandimi: Bashkia Mallakastër nëpërmjet strukturave përkatëse, të marrë masa të menjëhershme për eliminimin e praktikave të kualifikimit dhe shpalljes fitues të operatorëve ekonomik në kushtet e mos plotësimit të kriterëve të miratuara në DST, procedura të cilat deri më tani kanë sjellë pasoja me efekte negative.

Në vijimësi

C. MASA ADMINISTRATIVE

C. 1. Për Agjencinë e prokurimit publik.

Referuar shkeljeve të konstatuara në fushën e prokurimeve publike, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe përgjegjësitë individuale të evidentuar

dhe pasqyruar në procesverbalet, vërejtjeve komentet e subjektit të audituar dhe pjesës së Raportit përfundimtar të auditimit.

Mbështetur në nenet 13 dhe 72 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, të ligjit nr. 10279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative” dhe bazuar në nenin 15 shkronja (c dhe ç) dhe nenin 30 të ligjit nr. 154/2014 miratuar në datën 27.11.2014, “Për Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, **i rekomandojmë Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Prokurimit Publik, të vlerësojë shkeljet e konstatuara**, duke vendosur marrjen e masave administrative (dënim me gjobë) në raport me të metat e mangësitë e konstatuara, **4 punonjësve** si më poshtë:

1- A. N., me detyrë Drejtor i Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, në cilësinë e anëtares së Njesisë Hartimit Dokumenteve të Tenderit, për të meta e mangësi në 4 procedura e prokurimi, konkretisht si më poshtë:

a)- Në procedurën e prokurimit me objekt “Rehabilitimi i rrjetit ujitës në zonën e Kutës (Rezervuari Çorrush nr.1), (vazhdim)”, me fond limit 20,833,333 lekë, zhvilluar në vitin 2017, fitues OE “Sh...” shpk me vlerë të ofertës 20,490,700 lekë, u konstatua se Dosja e procedurës nuk është arkivuar, inventarizuar dhe numerizuar në kundërshtim me ligjin për arkivat nr. 9154, datë 06.11.2003 nenin 4/26. Gjithashtu kriteret e përdorura nuk janë të argumentuar hollësisht mbi vendosjen e tyre pasi janë kërkuar kategori licence dhe staf teknik të cilat nuk janë të lidhura ngushtë me objektin e prokurimit, në kundërshtim me neni 46 të LPP dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për rregullat e prokurimit publik”, Neni 61 pika 2 paragrafi 2.

b)- Në procedurën e prokurimit me objekt “Rikonstruksion dhe shtesë kati në ndërtesën e Bashkisë”, me fond limit 49,999,932 lekë, zhvilluar në vitin 2017, fitues OE “Sh...” shpk me vlerë të ofertës 48,273,192 lekë, u konstatua se: Njësia e Prokurimit: Dosja e procedurës së prokurimit nuk është arkivuar, inventarizuar dhe numerizuar në kundërshtim me ligjin për arkivat nr. 9154, datë 06.11.2003 nenin 4/26. Gjithashtu kriteret e përdorura nuk janë të argumentuar hollësisht mbi vendosjen e tyre pasi është kërkuar numri i punonjësve dhe stafi teknik në mënyre të paargumentuar me volume pune, të cilat nuk janë të lidhura ngushtë me objektin e prokurimit, në kundërshtim me neni 46 të LPP dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për rregullat e prokurimit publik”, Neni 61 pika 2 paragrafi 2.

c)- Në procedurën e prokurimit me objekt “Rikualifikimi urban i lagjes “28 Nëntori” të qytetit Ballsh”, me fond limit 77,853,482 lekë, zhvilluar në vitin 2017, Fitues BOE “2...” shpk & “G...” shpk me vlerë të ofertës 77,491,570 lekë, u konstatua se: Njësia e Prokurimit: Dosja e procedurës nuk është arkivuar, inventarizuar dhe numerizuar në kundërshtim me ligjin për arkivat nr. 9154, datë 06.11.2003 nenin 4/26. Kriteret e përdorura nuk janë të argumentuar hollësisht mbi vendosjen e tyre pasi janë kërkuar kategori licence dhe numër punonjësish të cilat nuk janë të lidhura ngushtë me objektin e prokurimit, është vendosur kriter kufizues për distancë 30 km nga objekti prokurimit për fabrikën e asfaltobetonite, në kundërshtim me neni 1, 2 dhe 46 të LPP dhe VKM VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për rregullat e prokurimit publik”, Neni 61 pika 2 paragrafi 2.

d)- Në procedurën e prokurimit me objekt “KUZ Lagjia “Bylis”, qyteti Ballsh”, me fond limit 83,204,401 lekë, zhvilluar në vitin 2017, Fitues OE “B...” shpk me vlerë të ofertës 82,400,968 lekë, u konstatua se: Njësia e Prokurimit: Dosja e procedurës së prokurimit nuk është arkivuar, inventarizuar dhe numerizuar në kundërshtim me ligjin për arkivat nr. 9154, datë 06.11.2003 nenin 4/26. Gjithashtu kriteret e përdorura nuk janë të argumentuar hollësisht mbi vendosjen e

tyre pasi janë kërkuar kategori licence dhe numër punonjësish të cilat nuk janë të lidhura ngushtë me objektin e prokurimit, është vendosur kriter kufizues për distancë 30 km nga objekti prokurimit për fabrikën e asfaltobetonite, në kundërshtim me neni 1, 2 dhe 20 të LPP dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për rregullat e prokurimit publik”, Neni 61 pika 2 paragrafi 2.

2- H. S., me detyrë Zv/Kryetar Bashkie, në cilësinë e antarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave,

3- A. R., me detyrë Drejtor i Drejtorisë Ekonomike, në cilësinë e antarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave,

4- A. X., me detyrë Kryeinspektor i IMTV, në cilësinë e antarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave,

Për të metat e mangësitë e përbashkëta si më poshtë:

a)- Në procedurën e prokurimit me objekt “*Rehabilitimi i rrjetit ujitës në zonën e Kutës (Rezervuari Çorrush nr.1), (vazhdim)*”, me fond limit 20,833,333 lekë, zhvilluar në vitin 2017, fitues OE “Sh...” shpk me vlerë të ofertës 20,490,700 lekë, u konstatua se: KVO ka vepruar me dy standarde pasi ka kualifikuar dhe shpallur fitues OE me vlerë më të lartë me mangësi të njëjta me OE me vlerë më të ulët të skualifikuar duke shkaktuar impakt financiar negativ me dëm ekonomik në vlerën 1,708,100 lekë, në kundërshtim me nenin 1 dhe 2 të LPP.

b)- Në procedurën e prokurimit me objekt “*Rikonstruksion dhe shtesë kati në ndërtesën e Bashkisë*”, me fond limit 49,999,932 lekë, zhvilluar në vitin 2017, fitues OE “Sh...” shpk me vlerë të ofertës 48,273,192 lekë, u konstatua se: KVO ka vepruar me dy standarde pasi ka kualifikuar dhe shpallur fitues OE me vlerë më të lartë me mangësi të njëjta me OE me vlerë më të ulët të skualifikuar duke shkaktuar impakt financiar negativ me dëm ekonomik në vlerën 2,028,905 lekë, në kundërshtim me nenin 1 dhe 2 të LPP.

c)- Nga auditimi i dy procedurave të prokurimit publik me objekt “*Rehabilitimi i rrjetit ujitës në zonën e Kutës (Rezervuari Çorrush nr.1), (vazhdim)*”, me fond limit 20,833,333 lekë, zhvilluar në datë 04.05.2017, kontrata lidhur më datë 05.06.2017 dhe “*Rikonstruksion dhe shtesë kati në ndërtesën e Bashkisë*”, me fond limit 49,999,932 lekë, zhvilluar në datë 10.05.2017, kontrata lidhur më datë 05.06.2017, u konstatua se në të dyja këto procedura është shpallur fitues dhe lidhur kontratë me të njëjtin OE “Sh...” shpk, i cili ka deklaruar të njëjtat makineri dhe pajisje. Fakt i cili flet për paraqitje dokumentacioni të rremë nga ana e OE “Sh...” shpk në lidhje me disponimin dhe mospërdorimin e makinerive në objekt tjetër, si pasojë, KVO duhej ta kishte dërguar për përjashtim nga prokurimet publike në AP, duke vepruar në kundërshtim me LPP, Neni 13, pika 3/a, dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për rregullat e prokurimit publik”, neni 66.

d)- Në procedurën e prokurimit me objekt “*Rikualifikimi urban i lagjes “28 Nëntori” të qytetit Ballsh*”, me fond limit 77,853,482 lekë, zhvilluar në vitin 2017, Fitues BOE “2..” shpk & “G...” shpk me vlerë të ofertës 77,491,570 lekë, u konstatua se: KVO duhej të kishte anuluar tenderin pasi asnjë nga OE pjesëmarrës nuk ka plotësuar kriteret e kërkuar në DST duke shkaktuar mos përdorim me efektivitet, eficencë dhe economicitet të fondeve në vlerën 4,348,957 lekë, në kundërshtim me nenin 1, 2 dhe 20 të LPP.

e)- Në procedurën e prokurimit me objekt “*KUZ Lagjja “Bylis”, qyteti Ballsh*”, me fond limit 83,204,401 lekë, zhvilluar në vitin 2017, Fitues OE “B...” shpk me vlerë të ofertës 82,400,968 lekë, u konstatua se: KVO duhej të kishte anuluar tenderin pasi asnjë nga OE pjesëmarrës nuk ka

plotësuar kriteret e kërkuar në DST duke shkaktuar mos përdorim me efektivitet, efikasitet dhe ekonomikitet të fondeve në vlerën 6,686,327 lekë, në kundërshtim me nenin 1, 2 dhe 24 të LPP.

C.2. Bazuar në nenin 13, pika 3/a, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, ndryshuar i rekomandojmë Agjencisë së Prokurimit Publik, përjashtimin nga procedurat e prokurimit publik të operatorit ekonomik “Sh...” shpk për deklaratë të rreme, konkretisht: Nga auditimi i dy procedurave të prokurimit publik me objekt “Rehabilitimi i rrjetit ujitës në zonën e Kutës (Rezervuari Çorrush nr.1), (vazhdim)”, me fond limit 20,833,333 lekë, zhvilluar në datë 04.05.2017, kontrata lidhur më datë 05.06.2017 dhe “Rikonstruksion dhe shtesë kati në ndërtesën e Bashkisë”, me fond limit 49,999,932 lekë, zhvilluar në datë 10.05.2017, kontrata lidhur më datë 05.06.2017, u konstatua se në të dyja këto procedura është shpallur fitues dhe lidhur kontratë me të njëjtin OE “Sh...” shpk, i cili ka deklaruar të njëjtat makineri dhe pajisje. Fakt i cili flet për paraqitje dokumentacioni të rremë nga ana e OE “Sh...” shpk në lidhje me disponimin dhe mospërdorimin e makinerive në objekt tjetër.

C.3. Referuar shkeljeve të konstatuara në fushën e ndërtimit, përcaktuar në nenit 7 dhe 12 i ndryshuar, Kreu III, nenet 15 e 16 të ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar dhe Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, Kreu II, Pika 3, bazuar në nenin 15 dhe nenin 30, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, i rekomandojmë, Kryetarit të Bashkisë Mallakastër t’i kërkojë Kryeinspektorit të Inspektoratit të Mbrotjtjes së Territorit Vendor, të vlerësojë shkeljet e konstatuara dhe të vendosë masë administrative me gjobë për 1 mbikëqyrës punimesh dhe 1 kolaudator, si më poshtë:

1. E. M., me nr. licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK.2892, për shkeljet e konstatuara në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve në objektin: “**Rikonstruksion i pjesshëm i rrugëve në fshatrat e Bashkisë Mallakastër**”, me sipërmarrës punimesh BOE “F...” Sh.p.k & “Sh...” shpk, me pasojë dëm ekonomik në vlerën **5,506,460 lekë pa TVSh**, si rrjedhojë e diferencave në volume pune të likuiduara por të pakryera në fakt.

2. Z. G. S., me nr. licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK.2928/2, për shkeljet e konstatuara në cilësinë e kolaudatorit të punimeve në objektin: “**Rikonstruksion i pjesshëm i rrugëve në fshatrat e Bashkisë Mallakastër**”, me sipërmarrës punimesh BOE “F...” Sh.p.k & “Sh...” shpk, me pasojë dëm ekonomik në vlerën **5,506,460 lekë pa TVSh**, si rrjedhojë e diferencave në volume pune të likuiduara por të pakryera në fakt.

OPINIONI AUDITIMIT

Në bazë të punës audituese të kryer, të përshkruar në Kreun II të Raportit Përfundimtar të Auditimit, Grupit të Auditimit i rezulton se veprimtaria e Bashkisë Mallakastër, për periudhën 2016-2017, është në përputhje në çdo aspekt material me kërkesat e kuadrit rregullator në fuqi, Kreu I, germa g) të Raportit Përfundimtar të Auditimit për sa i përket: Planifikimit dhe zbatimit të planit të buxhetit, bazuar në ligjin organik të buxhetit dhe në ligjin nr. 130/2016, datë 17.12.2016 “Për buxhetin e shtetit të vitit 2017”, me ndryshimet e tij, Programimit të PBA 2017-2019 dhe programimit të buxhetit të vitit 2016, 2017, Çeljes së fondeve buxhetore të vitit dhe ndryshimet e tij gjatë vitit sipas Akteve Normative, saktësisë së realizimit të treguesve kundrejt

treguesve të planifikuar dhe të pasqyruar në raportet e monitorimit, planifikimit dhe realizimit të të ardhurave të institucionit dhe zbatimit të dispozitave nënligjore në përdorimin e tyre.

Gjithashtu veprimtaria e Bashkisë Mallakastër përputhet me kërkesat e kuadrit rregullator në fuqi përse i përket prokurimit të fondeve për mallra dhe shërbime dhe likuidimit të tyre me përjashtim të procedurave ku mospërputhjet shoqërohen me dëm ekonomik për buxhetin në shumën **15,313,645 lekë**nga të cilat: 6,892,925 lekë në zbatimin e kontratave për punë publike; 8,085,962 lekë, në procedurat e prokurimit dhe, 334,758 lekë shpenzimet operative sipas urdhërshpenzimeve të bankës.

***Shënim:** Në rastin e fillimit të proceseve gjyqësore në funksion të zbatimit të këtij rekomandimi, nga ana e Bashkisë, të kërkohet prezenca e KLSH-së, si palë e tretë në proces gjyqësor, duke e njoftuar me shkresë zyrtare KLSH-në, në lidhje me ecurinë dhe zhvillimet përgjatë procesit gjyqësor dhe në të gjitha shkallët e gjykimit.*

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore.

Bujar LESKAJ

K R Y E T A R